



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Panairi “Shqipëria punon Tokën”

2017-11-22 15:45:00



Produkti shqiptar vjen për herë të parë në një hapësirë të përbashkët në zemër të Tiranës.

Me iniciativën e Kryeministrit Z. Edi Rama, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës organizojnë në datat 29 dhe 30 Nëntor, Panairin “Shqipëria punon Tokën”. Ky është panairi më i madh bujqësor, blegtoral, që do të hapë dyert për fermerë, blegtorë dhe sipërmarrës shqiptarë dhe atyre të trojeve shqiptare jashtë kufirit, si Kosova dhe Maqedonia.

Produktet shqiptare që do të ekspozohen, do të përcillen tek njerëzit, nën skenografinë e vendit ku prodhohen. Gjithashtu pranë këtij panairi do të gjeni një arenë të manifestimit të kulinarisë shqiptare ku mjeshttrat e kuzhinës dhe restorantet, do të ofrojnë mundësinë e degustimit të recetave më të spikatura.

Në panair do të jenë rreth 500 ekspozitorë të ndarë në këto kategori kryesore: Të rinjtë sipërmarrës në bujqësi, Agroindustri, Verëra, alkool, Agroturizëm, Fruta-perime, Blegtori, Produkte shtëpie – tradicionale, Banka, fonde garancie në bujqësi etj.

Risia e këtij panairi do të jetë hapësira që do t’u dedikohet të rinjve dhe sipërmarrësve të rinj, në sektorin bujqësor dhe blegtoral. Në panair do të gjeni informacion për skemat mbështetëse dhe të gjithë instrumentat e financimit, asistencë në hartimin e planeve të biznesit, këndin e mjeteve bujqësore, këndin e të rinjve si dhe këndin e gatimit ku do të gjeni gatimet tona tradicionale.